



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN KOMBËTAR TË ARSIMIT BAZË
(PKAB)**

LËNDA

“GJUHË SHQIPE”

VITI SHKOLLOR 2018 - 2019

I. HYRJE

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Ajo synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, lënda e gjuhës shqipe i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve letrare dhe jo letrare, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore.

Lënda e gjuhës shqipe nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë.

Arritjet e nxënësve në gjuhën shqipe janë përcaktuese për lëndët tjera të fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, si dhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Gjithashtu, nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm jo vetëm në shkollë, por dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, lënda e gjuhës shqipe është një nga detyrat parësore të arsimit parauniversitar. Arritjet e nxënësve në gjuhën shqipe vlerësohen në testime kombëtare në përfundim të çdo cikli. Për t’i orientuar nxënësit në këto testime hartohen programe orientuese.

Programi orientues për PKAB në lëndën e gjuhës shqipe ka si qëllim të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesit e testeve përfundimtare për PKAB.

Hartimi i programit orientues është mbështetur në kurrikulën me kompetenca të lëndës së gjuhës shqipe (klasat 6-9) dhe përfshin konceptet, njohuritë, aftësitë dhe shprehjet më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

II. Përmbajtja e programit

Programi orientues për PKAB bazohet në parimin se të zotërosh njohuri dhe aftësi në lëndën e gjuhës shqipe do të thotë të jesh në gjendje t’i demonstrosht ato në tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare, në situata të jetës së përditshme.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, në program përshkruhen:

- kompetencat gjuhësore që do të vlerësohen në PKAB;
- pesha e kompetencave në programet e gjuhës shqipe;
- struktura e testit;
- llojet e pyetjeve/ ushtrimeve/ kërkesave që vlerësojnë në mënyrë efektive kompetencat gjuhësore që zotëron nxënësi.

Gjithashtu, programi përmban edhe rubrikën ku përcaktohen njohuritë dhe aftësitë kryesore për çdo kompetencë që do të vlerësohet.

II. Përshkrimi i kompetencave gjuhësore

Bazuar në specifikat e PKAB, kompetencat gjuhësore që vlerësohen janë:

a) Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

Nxënësi zhvillon njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar, për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste të ndryshme jo letrare, si: kronika, biografi, kujtime, udhëpërshkrime, intervista, rregullore, përmbledhje, udhëzime, reklama, ese të ndryshme dhe fjalime.

Nxënësi: lexon dhe punon me tekste nga krijimtaria popullore gojore, nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, si dhe nga periudha e gjini të ndryshme; përshkruan dhe diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti; veçon temën kryesore. Ai analizon personazhet, dallon dhe shpjegon figurat letrare, si dhe gjykon e vlerëson elemente të formës dhe të përmbajtjes së një teksti letrar.

Nxënësi elementet kryesore të metrikës në një tekst poetik, diskuton rreth atmosferës që krijon ai, analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve kryesore të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik.

Nxënësi lexon lloje të ndryshme të prozës, dallon temën kryesore, përshkruan me detaje nga teksti subjektin e një proze. Ai përcakton tiparet kryesore të disa teksteve në prozë, si: përralla, tregimi, novela, romani.

Nxënësi përcakton tiparet kryesore të tragjedisë, komedisë dhe dramës, analizon tiparet e personazheve dhe tregon funksionet e elementeve të veçanta të dramës.

b) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi ndjek të gjithë hapat e domosdoshëm të procesit të të shkruarit (*planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi*). Ai shkruan duke zbatuar karakteristikat e formës, të përmbajtjes

dhe të strukturës, tekste të tilla si: kronika, rrëfime personale, intervista, letra, ese, udhëzime, fletëpalosje, CV, ftesa, përshkrime.

c) Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi demonstroi njohuri, shkathtësi dhe qëndrime: për gjymtyrët kryesore dhe të dyta, për llojet e fjalive sipas kumtimit, pohimit dhe mohimit dhe sipas gjymtyrëve kryesore, për përdorimin e ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë, për fjalët e ndryshueshme (kategoritë e tyre gramatikore) dhe fjalët e pandryshueshme, për përbërësit e fjalës dhe mënyrat e formimit të saj. Nxënësi, gjithashtu, zbaton rregullat drejtshkrimore.

III. Pësja e kompetencave në programin e gjuhës shqipe

| Kompetenca | Pësja |
|---|--------------|
| Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare | 45 % |
| Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale. | 15 % |
| Përdorimi i drejtë i gjuhës. | 40 % |

Kompetencat gjuhësore ndërtohen dhe zhvillohen nëpërmjet punës dhe angazhimit të nxënësit me tekste letrare dhe jo letrare. Për sa i përket përfaqësimit të teksteve letrare dhe teksteve jo letrare, në program sugjerohet raporti: 70% me 30%.

Nxënësi testohet për aftësitë, të cilat janë të vëzhgueshme, të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara në lëndën e gjuhës shqipe, si:

- aftësitë për të identifikuar dhe për të kuptuar (40 %);
- aftësitë për të analizuar, për të përdorur dhe për të zbatuar njohuritë në tekste të ndryshme (40%);
- aftësia për të vlerësuar, për të gjykuar dhe për të mbajtur qëndrime të caktuara (20%).

IV. Struktura e testit

Pjesa e parë: Tekst/e letrare

Pjesa e dytë: Tekst/e jo letrare

Pjesa e tretë: Njohuritë dhe aftësitë rreth sistemit gjuhësor

Fragmentet ose tekstet në test janë të panjohura për nxënësit dhe nuk janë pjesë e teksteve mësimore.

V. Llojet e pyetjeve/ kërkesave të rekomanduara

Pyetjet që përdoren në test janë:

- Pyetje me alternativa.
- Pyetje me përgjigje: *E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar.*
- Pyetje me kombinime (me çiftim).
- Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar.

VI. SHKATHTËSITË DHE NJOHURITË SIPAS KOMPETENCAVE

Për secilën kompetencë janë paraqitur shkathhtësitë dhe njohuritë që duhet të demonstrojë nxënësi.

| <i>Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare</i> | |
|---|----------------------|
| Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë | |
| Nxënësi: | |
| <ul style="list-style-type: none">- kupton, analizon, gjykon dhe vlerëson tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare;- interpreton tekstin duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara;- dallon informacionin e rëndësishëm në një tekst. | |
| Tekste letrare | |
| <ul style="list-style-type: none">- dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;- analizon figurat kryesore stilistike në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike, si dhe tregon funksionin e tyre;- dallon dhe analizon tiparet kryesore të gjuhës dhe të stilit në një tekst. | |
| Tekste jo letrare | |
| <ul style="list-style-type: none">- dallon përdorimin e gjuhës dhe të terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;- analizon tiparet e strukturës dhe të organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.). | |
| Njohuritë | Shkathhtësitë |

| | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Tekstet letrare dhe jo letrare. Dallimet kryesore mes tyre. - Tema ose motivi kryesor. - Idetë dhe informacionet e tekstit. - Struktura e tekstit. - Tekstet të ndryshme letrare: tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike. Tiparet kryesore të tyre. - Gjuha e figurshme. Figurat stilistike: <i>personifikimi, antiteza, krahasimi, hiperbola, metafora.</i> - <i>Teksti poetik:</i> Rima dhe strofat në një tekst poetik. Tiparet kryesore të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik. <i>Teksti në prozë:</i> Tiparet kryesore të disa teksteve në prozë (përralla, fabula, tregimi, romani). Subjekti i një proze. Analiza e personazhit. Rrëfimtari. - <i>Teksti dramatik:</i> Elementet e strukturës së një teksti dramatik, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë. Monologu, dialogët në një tekst dramatik. - Tekstet jo letrare: përshkrime, rrëfime, kronika, biografi, kujtime, ditar, udhëpërshkrime, intervista, udhëzime, artikuj gazetash dhe revistash, ese të ndryshme etj. Tiparet kryesore të këtyre teksteve. | <p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin¹</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategji të ndryshme para, gjatë dhe pas leximit, si p.sh.: • praktikon rileximin për të kuptuar tekstin ose për të ngulitur në mendje detajet më të rëndësishme, • përqendrohet tek ilustrimet e tekstit për të plotësuar dhe për të zgjeruar informacionin e tekstit, • mban shënime gjatë të lexuarit, • përdor një organizues grafik për të shënuar faktet dhe idetë e rëndësishme; - tregon brendinë ose subjektin duke e ilustruar me detaje nga teksti; - interpreton tekstin dhe jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij; - zgjeron kuptimin mbi tekstet duke lidhur idetë në to me idetë dhe njohuritë e tij, si p.sh., përcakton nëse informacioni në një artikull përkon ose kundërshton njohuritë e tij ose përvojat e tij të mëparshme; - krahason pjesë të ndryshme brenda tekstit; - gjen një titull tjetër, të ndryshëm nga titulli i tekstit të dhënë; - dallon shkakun nga pasoja në një tekst; - dallon problemin dhe zgjidhjen e problemit në një tekst; - përmbledh idetë dhe mban qëndrim kritik ndaj tyre; - zbulon mesazhin në një tekst të dhënë; - analizon funksionin e tipareve kryesore të gjuhës të tekstit, si p.sh., rrëfimi në vetën e parë; - përcakton funksionin e disa elementeve të teksteve, si: grafikët, tabelat, pikturat etj.; - vlerëson idetë që përcjell teksti, duke argumentuar mendimin e tij; |
|---|--|

¹ Këto shkathtësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe jo letrare.

| | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - diskuton se si ndikon teksti tek ai, në botën emocionale ose në ndjesitë e tij. <p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon lloje të ndryshme tekstesh letrare; - grupon tekstet që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare; - përshkruan dhe diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti; - dallon figurat stilistike si: <i>personifikimi, antiteza, krahasimi, hiperbola, metafora</i>; - zbërthen figurat stilistike duke treguar funksionin shprehës të tyre. <p>Teksti poetik</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon me shprehësi lloje të ndryshme tekstesh poetike; - diskuton rreth atmosferës që krijon poezia; - dallon motivet në një tekst poetik; - dallon tiparet kryesore e metrikës në poezi (lloji i rimës dhe i strofës); - dallon vargun e lirë në një poezi; - analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik; - dallon dhe analizon disa lloje të teksteve poetike, si soneti, himni, elegjia etj., si dhe tiparet kryesore të tyre. <p>Teksti në prozë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon lloje të ndryshme të prozës; - përshkruan me detaje nga teksti subjektin e një proze; - dallon temën kryesore; - përcakton tiparet kryesore të disa teksteve në prozë, si: tregimi, romani, përralla, fabula etj.; - analizon personazhet, duke u përqendruar: te fjalët e autorit për personazhin, te fjalët, veprimet, mendimet e tij, te marrëdhëniet me personazhet e tjera; - sjell përvojat e tij të ngjashme me ato të |
|--|---|

| | |
|--|--|
| | <p>personazheve të një tregimi, përralle etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon mënyrën e rrëfimit në një tregim, roman etj., si p.sh.: rrëfim në formën e një letre, një ditari etj.; - dallon rrëfimtarin në një tekst. <p>Teksti dramatik</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon fragmente dhe vepra të ndryshme dramatike (tragjedi, komedi dhe dramë); - përcakton tiparet kryesore të tragjedisë, të komedisë dhe të dramës, si dhe përcakton ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre; - analizon subjektin e një teksti dramatik; - dallon dhe analizon elementet e strukturës së një teksti dramatik, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë; - tregon rolin që kanë personazhet në veprat dramatike; - veçon ngjashmëritë dhe dallimet mes një filmi, një tregimi ose një romani dhe një drame. <p>Të lexuarit e teksteve joletrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste nga kultura dhe kohë të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, si: kronika, biografi, kujtime, udhëpërshkrime, intervista, letra, rregullore, udhëzime, artikuj gazetash dhe revistash, ese të ndryshme, reklama etj.; - identifikon ngjarjet dhe çështjet kryesore në një tekst; - dallon dhe përdor njohuritë rreth elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet, citimi, bibliografia; - dallon argumentet <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> një çështjeje në një tekst. |
|--|--|

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;
- përdor forma të efektshme të të shkruarit për qëllime dhe audienca të ndryshme
- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idenë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.

| Njohuritë | Shkathtësitë |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Shkrime rrëfyese, si p.sh., përvoja vetjake, ngjarje të lexuara ose të dëgjuara. - Shkrime përshkruese, si p.sh.: përshkrime të natyrës, përshkrime të miqve, të personazheve, të heronjve imagjinarë etj. - Shkrimi i një mbylljeje tjetër të një teksti, të ndryshme nga varianti i dhënë. - Ditar. - Ese. - Përmbledhje e shkurtër. - Intervistë. - Letër formale dhe joformale. - rtikull i shkurtër për një revistë. | <p>Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit²</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh dhe zbaton në proces strategjitë e të shkruarit; - aktivizon njohuritë e mëparshme rreth temës për të cilën do të shkruajë; - rendit dhe organizon idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje, shembuj, fakte dhe opinione të ndryshme; - respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim dhe mbyllje); - përshtat gjuhën me llojin e detyrës me shkrim, me qëllimin dhe me lexuesin, p.sh.: në një letër drejtuar këshillit të prindërve të shkollës përdor një gjuhë formale, në një komunikim elektronik me shokët e shoqet përdor një gjuhë joformale, humorin, batutat etj.; - përzgjedh fjalët dhe frazat që i japin punës ose detyrës me shkrim gjallëri dhe shprehësi; - përdor lloje të ndryshme fjalish (lloj, gjatësi, strukturë) për të shtuar interesin e lexuesit dhe për të përmirësuar rrjedhën e punës me shkrim; - zbaton njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - përdor gjuhën standarde gjatë të shkruarit; - rishikon punët me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen, organizimin, qartësinë, stilin dhe gjuhën, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ☞ shton shembuj që mbështesin idenë kryesore, ☞ heq detaje të parëndësishme, ☞ shton fjalët e duhura në hyrje të çdo paragrafi që të krijojë idenë e vazhdimësisë së mendimeve |

² Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për të gjitha llojet e teksteve që shkruajnë nxënësit.

| | |
|--|---|
| | <p>dhe lidhjen mes tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> - shmang gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit. <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan rrëfime personale duke reflektuar mbi veten, mbi përvojat personale, mbi ngjarjet e kaluara etj.; - shkruan tregime nga bota reale ose imagjinare për tema që janë interesante për moshën; - realizon shkrime komentuese për poezi të ndryshme; - përshkruan dhe analizon personazhet e tij të preferuara dhe argumenton pëlqimin e tij; - krahason me shkrim personazhe nga tregime, përralla dhe fabula të ndryshme; - shkruan një mbyllje tjetër të një teksti, të ndryshme nga varianti i dhënë. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan një përmbledhje të shkurtër, p.sh., rreth një ngjarjeje në shkollë; - shkruan intervista për figura të njohura të sportit, të kinematografisë, të shkencës, të artit, të letërsisë etj.; - njeh dhe zbaton hapat e shkrimit të një eseje; - shkruan një udhëzim të shkurtër (p.sh., si funksionon një pajisje); - shkruan letra për qëllime dhe lexues të ndryshëm; - shkruan një fletëpalosje për tema dhe lexues të ndryshëm; - shkruan artikuj të shkurtër për revista. |
|--|---|

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit dhe gjymtyrëve kryesore;
- dallon, përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe të gjymtyrëve të dyta;
- dallon, përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të fjalëve të pandryshueshme;
- analizon fjalën sipas ndërtimit dhe fjalëformimit;
- vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde, zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.

Njohuritë

Shkathtësitë

Sintaksë

- Llojet e fjalive sipas kumtimit.
- Fjalitë pohore dhe fjalitë mohore.
- Fjalitë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe. Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore. Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore.
- Fjalitë e thjeshtë dhe fjalitë e përbërë.
- Fjalitë e përbëra me bashkërenditje.
- Fjalitë e përbëra me nënrenditje.
- Gjymtyrët kryesore (kryefjala dhe kallëzuesi).
- Gjymtyrët e dyta (përcaktori, kundrinori, rrethanori). Llojet.
- Ligjëratë e drejtë dhe ligjëratë e zhdrejtë.

Sintaksë

Nxënësi:

- përcakton llojin e fjalisë sipas kumtimit;
- ndërton fjali të ndryshme dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore;
- dallon llojin e fjalisë sipas ndërtimit (përbërjes);
- përcakton llojin e fjalisë sipas modalitetit: mohore, pohore;
- dallon fjalinë dykryegjymtyrëshe dhe fjalinë njëkryegjymtyrëshe;
- ndërton fjali njëkryegjymtyrëshe foljore;
- ndërton fjali njëkryegjymtyrëshe emërore;
- dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalitë e përbërë;
- përcakton llojin e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;
- ndërton fjali të ndryshme me bashkërenditje dhe me nënrenditje;
- ndërton skemën e një fjalie të përbërë;
- shndërron fjalinë e thjeshtë në të përbërë;
- dallon funksionet gramatikore të gjymtyrëve (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, kundrinor, rrethanor) në një fjali të dhënë dhe përcakton se me çfarë shprehen;
- përcakton llojet e kundrinorëve;
- përcakton llojet e përcaktorëve;
- përcakton llojet e rrethanorëve;
- përdor në fjali kundrinorin, përcaktorin dhe rrethanorin;
- dallon ligjëratën e drejtë nga e zhdrejtja;
- kthen ligjëratën e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjellas.

| | |
|---|---|
| <p>Morfologji</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme. - Kategoritë gramatikore të emrit. - Kategoritë gramatikore të mbiemrit. - Forma, mënyra, veta, numri dhe koha e foljeve. - Foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i> me funksion të mëvetësishëm dhe ndihmës. - Format e pashtjelluara të foljes. Llojet. - Përemrat. Llojet. Kategoritë gramatikore. - Ndajfoljet. Llojet. - Lidhëzat. Llojet. - Parafjalët sipas rasave. | <p>Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon klasat e fjalëve; - analizon kategoritë gramatikore të emrit; - përcakton gjininë, numrin, rasën dhe shkallën e mbiemrit; - përcakton formën, mënyrën, vetën, numrin, kohën e foljeve; - dallon dhe përdor në fjali, foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i> me funksion të mëvetësishëm dhe ndihmës; - dallon dhe përdor format e pashtjelluara; - analizon funksionet e formave të pashtjelluara; - përcakton llojin e përemrave; - analizon veçoritë gramatikore të përemrave të ndryshëm; - dallon dhe përdor trajtat e shkurtra dhe të bashkuara (tri pozicionet); - dallon pjesëzën <i>u</i> të joveprores nga trajta e shkurtër <i>u</i>; - dallon përemrin vetor të vetës së tretë nga përemri dëftor; - gjen ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre; - dallon lidhëzat dhe përcakton llojin e tyre; - dallon parafjalët sipas rasave. |
| <p>Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjala dhe përbërësit e saj. - Fjalët e thjeshta dhe fjalët jo të thjeshta. - Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. - Fjalët e prejardhura. - Fjalët e përbëra. - Fjalët e përngjitura. | <p>Fjalëformim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon përbërësit e fjalës; - dallon fjalët e thjeshta nga fjalët jo të thjeshta; - përcakton mënyrën e formimit të fjalëve; - dallon fjalët e prejardhura dhe përcakton llojin e tyre; - formon fjalë të prejardhura; - dallon dhe formon fjalë të përbëra; - dallon dhe formon fjalë të përngjitura. |
| <p>Leksikologji</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha standarde shqipe. - Kuptimet e fjalëve. - Kuptimi i figurshëm i fjalëve. - Familja e fjalëve. - Sinonimet dhe antonimet. - Shprehjet frazeologjike. | <p>Leksikologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit dhe të shkruarit; - shmang fjalët e huaja gjatë të shkruarit; - përcakton dhe analizon kuptimet e fjalës; - dallon kuptimin e figurshëm të fjalës; - ndërton familjen e fjalëve të ndryshme me jo me pak se katër fjalë; - krijon çifte sinonimie dhe antonimie; - dallon dhe përdor në fjali shprehjet frazeologjike. |

| | |
|---|---|
| <p>Drejtshkrim dhe pikësim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i shenjave të pikësimit. - Përdorimi i apostrofit. - Drejtshkrimi i shkronjës së madhe. - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në trup dhe në fund të fjalës. - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore: <i>sh, zh, ç, s, z</i>. - Drejtshkrimi i zanoreve: <i>e, ë, i/y, u/y</i>. - Drejtshkrimi i fjalëve që përmbajnë grupet e zanoreve: <i>ye, ua, ie</i>. - Drejtshkrimi i datave. - Drejtshkrimi i fjalëve që mbarojnë me: <i>-ër, -ërr, ël</i> në shumës. | <p>Drejtshkrim dhe pikësim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor saktë shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë; - përdor drejt apostrofin; - përdor saktë shkronjën e madhe; - shkruan drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës; - përdor saktë bashkëtingëlloret nistore: <i>sh, zh, ç, s, z</i>; - përdor drejt zanoret: <i>e, ë, i/y, u/y</i>; - shkruan saktë fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: <i>ye, ua, ie</i>; - shkruan saktë datat; - shkruan drejt fjalët që mbarojnë me: <i>-ër, -ërr, ël</i> në shumës. |
|---|---|